



E ardhmja nis me ne!



“HORIZON SCHOOL”

Njësia Lipjan



PLANP ROGRAMI VJETOR 2023/2024

SHTATOR, 2023

Tabela e përmbajtës

Misioni, vizioni dhe objektivat	3
Parametrat	3
Besimet	4
Qëllimet	4
Hyrje	5
Regjistrimet në shkollën tonë	6
Financimi	6
Hapësira e punës dhe pajisjet	7
Organizimi i punës	7
Shënime për nxënësit dhe ndarjen e klasave	7
Aktivitetet e lira të nxënësve	8
Bashkëpunimi me prindër	13
Programi i punës së bibliotekës	14
Organet profesionale të shkollës	14
Këshilli i mësimdhënësve	15
Këshilli i klasave	15
Analiza pedagogjike dhe statistika	16
Trajnime profesionale të punëtorëve	16

Misioni, vizioni dhe objektivat

Veprimtaria kryesore e Horizon School është ofrimi i programeve mësimore të cilat do të zhvillohen në bazë të plan programeve të aprovuara nga MASHT, por gjithmonë duke futur elementin e punës arsimore në bllok.

Misioni i Horizon School është inspirimi i nxënësve për “shfrytëzim të mendjes së shëndoshë, zemrës së pastër dhe jetës për të mirën e njerëzimit” duke punuar ne partneritet me bashkësinë për të ofruar programe inovative për të gjithë nxënësit, për të zbuluar aftësitë unike të tyre, për të inkurajuar ata drejtë perfektësisë në jetën e tyre.

Të zbulojmë së bashku potencialin e secilit fëmijë, përmes edukimit dhe arsimimit profesional dhe cilësor. Gjeneratat e arta të arsimit para-universitar të kalojnë përmes dritareve të dijesë Horizon School, me përkushtimin dhe etikën më të lartë të të mësuarit.

Në vizionin tonë për tre vitet e ardhshme është të vazhdojmë të jemi kampion të arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm në Qytetin e Pejës dhe Rrafshin e Dukagjinit, duke avancuar dhe pasuruar edhe më tej programin tonë të të mësuarit, me përvoja, gara dhe programe ndërkombëtare. Ti fitojmë të gjitha garat shkencore lokale dhe të jemi konkurrues në nivel qendror.

Parametrat

Standarde për të cilat Horizon School nuk bën kompromise:

- Ne do të ofrojmë veprimtari shkollore në nivelet më të larta sipas traditës së ekselencës;
- Ne regjistrojmë nxënësit të cilët tregojnë rezultate në provime pranuese;
- Ne praktikojmë përgjegjësi fiskale duke respektuar vendimet e bordit të shkollës dhe vlerësuar lartë gatishmërinë e prindërve për të investuar në fëmijët e tyre;
- Ne do të kujdesemi që ambienti në shkollë t'i përgjigjet standardeve të shkollimit modern;
- Ne do të mbajmë baraspeshë në mes të individit dhe shoqërisë.

Besimet

(Shprehje e vlerave fundamentale të shkollës është: kodi i etikës, respektimi i procesit mësimor, dhe promovimi i përgjegjësisë ndaj të tjerëve)

Ne besojmë se:

- Secili njeri është unik, ka vlera dhe meriton respekt.
- Diversiteti pasuron individin, shkollën dhe komunitetin.
- Secili person mund të mësojë.
- Individët janë përgjegjës dhe llogaridhënës për veprat e tyre.
- Edukimi është përgjegjësi e ndarë me nxënësit tjerë, familjen, shkollën dhe komunitetin.
- Mirëqenia emocionale, fizike dhe sociale ndihmon në mësim dhe jetë.
- Integriteti, civilizimi dhe sinqeriteti janë vitale për interaksionin njerëzor.
- Tendenca drejt ekselencës në edukim justifikon investimin në kohë, mund dhe resurse.
- Secili individ ka përgjegjësi për të kontribuar për të tjerët, shoqërinë dhe ambientin.
- Guximi për të rrezikuar dhe gatishmëria për të mësuar nga gabimet ofrojnë mundësi për rritje.
- Mësimi gjatë jetës (lifelong learning) kontribuon për jetë kuptimplote.

Qëllimet:

Përcaktimet e shkollës për të arritur rezultate të matshme:

- Të gjithë nxënësit do të hulumtojnë aspiratat e tyre individuale, talentin, dhe interesat për të përcaktuar qëllime kuptimplote, në mënyrë që me guxim ti qasen realizimit të ëndrrave të tyre;
- Të gjithë nxënësit do të demonstrojnë se ata bëjnë kombinime kuptimplote në mes të përvojës së mësimit me përvojën akademike, sociale dhe personale;
- Të gjithë nxënësit në mënyrë konsistente do të demonstrojnë etikë në sjellje si qytetar të përgjegjshëm;
- Të gjithë nxënësit do të zgjedhin rrugën që promovon jetë stabile dhe të shëndoshë.

Hyrje

Horizon School ka filluar me punë në shator të vitit 2006, pas licencimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Për 13 vite punë ka arritur të jetë një ndër shkollat më të mira në Kosovë duke treguar rezultate të shkëlqyeshme në testet e arritshmërisë dhe atë të maturës shtetërore, gara shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Kalueshmëria e nxënësve në këto teste të cilat organizohen, monitorohen dhe kontrollohen nga MASHT në shkollën tonë është 100%, ndërsa arritshmëria është 90%, për dallim nga mesatarja e shkollave të tjera e cila është shumë më e ulët. Maturantët kanë arritur rezultate shumë të mira duke u regjistruar në universitete brenda dhe jashtë vendit.

Horizon School është ndërmarrje private e themeluar në qershor të viti 2003, sipas vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me numër biznesi 70024508, si Biznes Individual, për ta plotësuar-ndryshuar në vitin 2017 statusin ligjor në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, me numër unik identifikues të biznesit 810029852. Selia e Horizon School është në Pejë, rruga Muharrem Mitrovica pn.

Veprimtaria e Horizon School është edukimi dhe mësimdhënia sipas programit të MASHT-it për arsimin para-universitar dhe në harmoni me plan programet e miratuara nga MASHT-it.

Shkollimi në Horizon School sipas reformës së aprovuar nga MASHT-i dhe në harmoni me sistemin evropian të shkollimit të mesëm është i organizuar në katër nivele:

- shkollimin parafillor (4-6 vjeç);
- shkollimin fillor (klasat 1-5);
- shkollimi i mesëm i ulët (klasat 6-9);
- shkollimin e mesëm të lartë (klasat 10 – 12)
 - drejtimi shkenca natyrore;
 - matematikë-informatikë;
 - mjekësi të përgjithshme.

Nxënësit të cilët përcaktohen për programin e kësaj shkolle, do pajisen me njohuri të duhura nga mësimdhënës të dalluar për studime në shkencat ekzakte, shoqërore dhe për mësimin e gjuhëve të huaja.



E ardhmja nis me ne!



Karakteristika bazë e programit është realizimi i baraspeshës dhe harmonizimit në mes të gjitha fushave arsimore dhe edukative, prandaj programi i gjimnazit i'u mundëson nxënësve qasje në tërë spektrin arsimor, duke i përgatitur ata për përvetësimin efektiv të materieve mësimore nga shkencat humanitare dhe ato natyrore. Horizon School i 'u ofron nxënësve program modern të gjuhëve të huaja dhe teknologji informative e cila i bën ata konkurrent të fortë për vazhdimin e shkollimit universitar.

Regjistrimet në shkollën tonë

Regjistrimet bazohen në selektimin paraprak të nxënësve nga pedagogët profesional, komfor rregullave dhe plan-programeve të përcaktuara nga MASHT-i, si dhe komfor politikës së shkollës e cila përcaktohet nga Menaxhmenti i shkollës. Shkolla pranon nxënës në ciklin PF të moshës 4 deri në 6 vjeç, SHF prej klasës së I-rë deri në klasën e 5- të, në SHMU prej klasës së 6-të deri në klasën e 9-të në drejtim të përgjithshëm, si dhe nxënës në SHML prej klasës së 9-të deri në klasën e 12-të në drejtime shkenca natyrore, matematikë-informatikë dhe mjekësi të përgjithshme. Numri i nxënësve për klasë është i kufizuar në 25 nxënës, ndërsa klasa organizohet nga 8 nxënës e tutje.

Secili nxënës i pranuar ftohet me prindërit për të nënshkruar kontratë për shkollim, e cila specifikon qartë obligimet dhe të drejtat e nxënësit dhe të shkollës. Mësimi organizohet 5 ditë në javë dhe fillon në ora 8:30 deri në ora 15:30. Kjo kohë e qëndrimit në shkollë përfshinë orët e rregullta mësimore, orët plotësuese, orët shtesë sipas nevojave të nxënësve si dhe ushqimin.

Financimi

Shkolla financohet përmes pagesës së kryer nga nxënësit, me rastin e nënshkrimit të kontratës, si dhe nga donacione të mundshme.

Hapësira e punës dhe pajisjet

Shkolla gjendet në Pejë, në pjesën më pitoreske dhe më të shëndetshme të qytetit. Ka objekt shkollor prej 2284 m², i cili shquhet si një ndër objektet më të mira shkollore në Kosovë me hapësirë prej 1.5 ha ku zhvillohen aktivitete sportive dhe shoqërore. Objekti përbëhet nga 12 dhoma mësimi, klasën parafillore, kabineti i biologjisë, kimisë dhe ai i fizikës, kabineti i informatikës, kabineti i gjuhëve të huaja, biblioteka dhe qendra e të mësuarit aktiv, salla e arsimitarëve, atelieja për art figurativ, zyra e psikologut, zyra e drejtorit, gardëroba si dhe 4 nje sanitare. Objekti gjithashtu ka sallë të ushqimit dhe dyqan të vogël për nevoja të nxënësve, sallën e edukatës fizike prej 800 m² dhe fushën e jashtme sportive me shtegun e vrapimit, si dhe pishinën gjysmë olimpikë.

Orenditë e shkollës janë të standardeve moderne shkollore dhe janë me origjinë nga Evropa. Kabinetet e shkencës janë inovative dhe të avancuara. Klasat kanë tabela të mençura digjitale. Si dhe pajisje tjera të multi-komunikimit, teknologjia e fundit.

Pajisjet tjera të shkollës përbëjnë kompjuterët për kabinetin e informatikës si dhe kompjuterët e dhomave të punës së arsimitarëve dhe të administratës (të gjithë janë të lidhur në rrjetë dhe rrjeta funksionon sipas softuerit të punuar enkas për shkollë). Të gjithë kompjuterët janë të lidhur me lidhje 24 orëshe në internet të kapacitetit 30 GB. gjithashtu kabineti i informatikës i pajisur me pjesë harduerike dhe gjuhë programuese dhe të kodimit. Shkolla posedon me pajisje audio vizuale dhe mjete tjera pedagogjike konkretizimi. Sistemin e ditarit online, e-school dhe të mësuarit digjital.

Organizimi i punës

Shënime për nxënësit dhe ndarjen e klasave

Shkolla ka mbi 270 nxënës, duke filluar nga klasa para fillorë deri në atë të 12-të. Mësimi është i organizuar në të katër ciklet –shkollë para fillore, shkollë fillore, shkollë e mesme e ulët dhe shkollë e mesme e lartë. Të gjitha klasat kanë nxënës gjë që na ka mundësuar të kompletojmë ciklin e mësimdhënies dhe të fokusohemi në plotësimin e këtyre klasave, të investojmë edhe me tutje në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mësimi zhvillohet fillimisht në një ndërrim dhe dita e mësimit fillon prej orës 8:30 deri në ora 15:30, me pauzat të cilat parashihet gjatë ndërrimit të orëve mësimore si dhe me pauzë për pushimin e drekës. Plani i punës për një ditë pune do të mund të specifikohet kështu: fillimisht janë 3 orë mësimi nga 45 minuta, pason një orë për mësim shtesë dhe pastaj pason pauza e drekës 60 minutash. Pjesa tjetër e ditës organizohet në tri orë mësimi nga 45 minuta.

Krahas mësimit të rregullt dhe atij shtesë do të punohet edhe më nxënësit e dalluar (përgatitja për gara, vendore dhe ndërkombëtare). Nxënësit e dalluar aftësitë e veta mund ti tregojnë edhe në një grup aktivitete të lira. E njëjta zhvillohet edhe me nxënësit që kanë nevojë për mësim plotësues.

Aktivitete të lira të nxënësve

Me qëllim të plotësimit të nevojave individuale të nxënësve në shkollë organizohen aktivitetet të lira të ndryshme, me çka tentohet krijimi i talenteve të rinj, ndërsa mësimdhënësit do të ju ofrojnë asistencë. Këto aktivitete, duke mos u kufizuar vetëm në to, përfshijnë:

1. Punëtorja e kimisë - Një herë në javë Çka

punohet?

- Eksperiment të cilat përcjellin mësimin e rregullt dhe ato demonstrohen gjatë mësimit të rregullt;
- Eksperimente të cilat zgjerojnë diapazonin e njohurive nga lëmia e kimisë;
- Llogaritja kimike – stehiometrija;
- Zgjedhje e enigmave kimike;
- Ndërtimi i modelit të molekulave;
- Punimi i sistemit periodik të elementeve;
- Projekte të vogla;
- Projekte lidhur me ekologjinë;
- Mirëmbajtja dhe pasurimi i kabinetit të kimisë;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Përcjellje e risive në kimi

2. Grupi i artit- Një herë në javë

Çka punohet?

- Pikturimi dhe teknikat e pikturimit;
- Vizatimet;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Debat dhe vështrime kritike.

3. Grupi historiko-arkeologjike

Çka punohet?

- Metodatat e hulumtimit arkeologjik;
- Metodatat dhe teknikat e përpunimit të dokumenteve;
- Qasja e trajtimeve të lokaliteteve arkeologjike;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Vizita në Muzeun Arkeologjik të Kosovës si dhe vendeve ku bëhen hulumtime arkeologjike.

4. Klubi i debateve - Një herë në javë Çka

punohet?

- Zhvillimi i mendimit kritik;
- Debat grupor;
- Avancimi i të folurit publik;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Pjesëmarrja në takime javore, seminare debati, turnirë debati si dhe pjesëmarrjen në kampe debatesh me karakter ndërkombëtar.

5. Grupi Biologjik - Një herë në javë Çka

punohet?

- Hulumtime laboratorike;
- Analiza praktike të temave sipas kurrikulës;
- Rregullimi dhe kujdesi për akuariumin shkollor dhe për hapësirat e gjelbëruara të shkollës;

- Rregullimi i panove me kafshë nga territori i Kosovës;
- Punimi i albumit shkollor (herbariumi);
- Rregullimi panove me data të theksuara në fushën e biologjisë;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Vizitë institucioneve të ndryshme (muzetë, kopshte zoologjike dhe botanike);

6. Aktivitet sportive - Një herë në javë Çka

punohet?

- Organizimi i kalendarit të garave shkollore;
- Ushtrimet e vazhdueshme sipas grupeve dhe sporteve;
- Aktivitete futbollistike;
- Aktivitete basketbollistike;
- Aktivitete volejbollistike;
- Aktivitete hendbollistike;
- Aktivitete të vrapimit;
- Aktivitete të gjimnastikës;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Aktivitete të ping-pongut;
- Aktivitete të skijimi.

7. Grupi i teknologjisë - Një herë në javë

Çka punohet?

- Aktivitete praktike për pjesët harduerike të kompjuterit;
- Trajnim për instalimin e programeve softuerike;
- Mësim i gjuhëve programuese;
- Praktikimi i kodimit;
- Mirëmbajtja e ueb faqes së shkollës;
- Punë bazike për ndërtimin e ueb faqeve;
- Përgatitja për gara të ndryshme;
- Puna me pakot e Microsoft Office.

8. Grupi për matematikë - Një herë në javë

Çka punohet?

- Zgjedhja dhe argumentimi i detyrave të renda;
- Organizimi i garave me detyra logjike;
- Zgjidhja kreative e problemeve të ndryshme matematikore;
- Përgatitja për gara të ndryshme;

9. Puna me nxënës të talentuar

Detyra e parë e shkollës është që të identifikohen nxënësit e talentuar dhe të dizajnojnë motivim adekuat për organizimin dhe përcjelljen e grupeve respektivisht individëve me konsultime të nevojshme.

Sipas identifikimit të nxënësve përcaktohen edhe mësimdhënësit të cilët do t'i motivojnë dhe ti përcjellin ata në ngritjen e tyre profesionale. Këta nxënës do të kenë trajtim adekuat duke iu mundësuar atyre që të kenë më shumë kohë për t'u marrë me gjërat të cilat atyre iu përgjigjen.

10. Mësimi i organizuar

Një nga prioritetet e shkollës është që gjatë orarit të punës të kryhen të gjitha detyrat shkollore. Kjo nënkupton se në kuadër të orëve të pasdites do të punohet individualisht me grupe të nxënësve në detyrat e tyre praktike, përkatësisht në referate, raportime ose punë tjera të pavarura. Këto orë do të organizohen në atë mënyrë që nxënësit iu ofrohen arsimtarëve të lëndëve të ndryshme me pyetje, skica referatesh, raportesh, detyrash me shkrim me qëllim të konsultimeve. Kjo mundëson mësimin sipas zgjedhjes së nxënësit por në përkujdesje nga mësimdhënësi.

11. Aktivitetet publike dhe kulturore të shkollës

Një aktivitete e shkollës është organizimi i aktiviteteve kulturore të shkollës të cilat organizohen përmes punës së nxënësve në grupe dhe seksione.

Secilin vit nxënësit do të organizojnë programe dhe do të marrin pjesë në aksione të ndryshme me qëllim përmirësimin të ambientit si dhe do të bëjnë ndërlidhjen me shkolla dhe institucione tjera.

Shkolla do të motivojë nxënësit e saj për ndërlidhje bashkëpunimi me shkolla tjera në Kosovë dhe në rajon si dhe do të mobilizohet për kyçje të shkollës në iniciative rajonale dhe ndërkombëtare.

Përvjetorë të rëndësishme të kulturës dhe historisë sonë do të shënohen përmes organizimit të tribunave, ekspozitave si dhe manifestimeve të ndryshme kulturore.

12. Ekskursionet shkollore

Gjatë vitit shkollor organizohen tre ekskursionet për nxënësit e shkollës dhe ato në vjeshtë, dimër dhe në pranverë.

Ekskursioni vjeshtor realizohet brenda territorit të Kosovës, duke vizituar pasuritë natyrore të Kosovës si dhe disa monumente të historisë kombëtare. Ekskursioni dimëror organizohet në qendra skijimi. Ndërsa, ai pranveror organizohet në fillim të sezonit turistik, në bregdet.

Vetëm nxënësit me sukses dhe sjellje shembullore zgjedhën të marrin pjesë në ekskursionet shkollore.

13. Mbrojtja e ambientit dhe krijimi i shprehive të shëndosha

Tendenca për ambient të shëndoshë paraqet imperativ të kohës moderne. Krijimi i një vetëdije ekologjike është pjesë e edukimit dhe arsimimit të nxënësve dhe kjo do të realizohet në tri drejtime:

- krijimi i një ambienti estetik dhe higjienik në shkollë si dhe rregullimi i rrethinës së shkollës;
- eliminimi i shprehive të këqija, edukimi lidhur me dëmet e thithjes së cigares si dhe përdorimit të narkotikëve të ndryshëm;
- vizita parqeve kosovare ku nxënësit do të njihen me veprimet praktike për mbajtjen e ambientit.

Në pjesën e parë aktiviteti organizohet nga mësime të artit dhe muzikës si dhe do të përkrahët nga i gjithë kuadri mësimor. Në programin e dytë do të angazhohen mësime të edukatës qytetare, psikologu i shkollës dhe mjekët mysafir të cilët do të shpjegojnë ndikimet dhe pasojat e shprehive të këqija të përdorimit të narkotikëve të ndryshëm. Mësime të biologjisë, kimisë si dhe ata të edukatës fizike do të luajnë rol të rëndësishëm në këtë proces.

1. Java e mësimit të hapur

Me qëllim të nxitjes së interesit të nxënësve në të gjitha fushat shkencore organizohen javët e mësimit të lirë. Kjo do të jetë dy herë në secilin gjysmë vjetor. Ato janë organizime të inovacioneve (përcaktim i hapur i orës), si dhe të ndërrimeve përmbajtësore (brenda fushave të ndonjë disipline). Nxënësve i'u mundësohet të tregojnë dëshirat e tyre për zgjedhjen e disiplinave në formë të punës (ligjërata, ushtrime, punëtori etj.), ndërsa shkolla siguron ligjëruesit dhe organizon kohën e mbajtjeve të këtyre takimeve. Prandaj, procesi mësimor zhvillohet, mirëpo duke përdorur metoda të përfshirjes së gjerë. Në vend të mësimit të pavarur, kjo do të jetë java e punimeve të pavarura të cilat nxënësit do t'i parashtrajnë dhe modelojnë me ndihmën e ekspertëve.

Bashkëpunimi me prindër

Bashkëpunimi me prindër është një nga bazat e veprimtarisë arsimore. Përveç bashkëpunimit në kuadër të njësisë klasore (me kujdestarë dhe në mbledhjet e prindërve), prindërit përfshihen në punën e shkollës përmes KËSHILLIT TË PRINDËRVE në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e prindërve nga secila klasë. Këshilli është trup konsultativ i cili ndihmon shkollën në realizimin e programeve të ndryshme. Një herë në vit Këshilli dhe shkolla organizojnë ditën e prindërve – takim i prindërve me mësime të nxënësve në një ambient joformal.

Komunikimi me prindërit është i rregullt përmes ueb faqes së shkollës dhe platformës e- school ku secili prind ka mundësi diskrete për të parë në çdo kohë suksesin dhe gjendjen e fëmijut të tij. Këto të dhëna janë të rezervuara vetëm për prindërit dhe ato plotësohen nga kujdestari i klasës i cili tregon notimin, vijueshmërinë, sjelljen dhe komente tjera shtesë sipas nevojës.

Programi i punës së bibliotekës

Puna në bibliotekë mund të ndahet në disa lëmi kryesore:

- puna edukativo-arsimore me shfrytëzuesit e bibliotekës;
- puna bibliotekare për gjetje të informatave dhe dokumenteve;
- veprimtaria kulturore.

Këto fusha i' u ndihmojnë nxënësve të krijojnë një tërësi e cila i' u mundëson atyre të gjejnë dhe shfrytëzojnë literaturë shtesë për punë të pavarur në shkollë.

Duke konsideruar se shumica e shfrytëzuesve të bibliotekës janë nxënës, është e nevojshme ndihma në përzgjedhjen e materies si dhe në realizimin e disa njësive të veçanta si për klasën ashtu edhe për individ të caktuar.

Qëllimi i kësaj pune është pavarësimi i nxënësve për të zgjedhur tema studimi, hulumtuar dhe argumentuar temat e tyre sipas interesave individuale. Në këtë drejtim është me rëndësi që të zhvillohen tek nxënësit aftësitë për qasje selektive dhe novative në përzgjedhjen e informacioneve, të thellojnë njohuritë nga burime të ndryshme informacionesh, studimi i pavarur si dhe puna hulumtuese shkencore. Ky lloj edukimi zakonisht bëhet në baza individuale.

Fondi i bibliotekës është i organizuar sipas sistemit të hapur, ashtu që nxënësit mund të shfrytëzojnë literaturën pa kufizime. Fondi fillestar do të plotësohet me tituj të tjerë të cilët paraqiten si nevojë.

Organet profesionale të shkollës

Në shkollë puna profesionale koordinohet dhe përparohet përmes organeve profesionale siç janë: Këshilli i mësimdhënësve, Këshilli i klasave dhe kujdestarët.

Këshilli i mësimdhënësve dhe këshilli i klasave caktohen për organizim, përgatitje dhe mbajtje të provimeve përmirësuese, për komisione vjetore për provime përfundimtare si dhe për komisione dhe këshilla tjera të nevojshme.

Këshilli i mësimdhënësve

Këshilli i mësimdhënësve diskuton për çështjet në vijim:

- Adoptimi i programeve për lëndët fakultative;
- Caktimi i kujdestarëve;
- Planifikimi dhe programimi i punës edukativo arsimore;
- Qasja edukative në shkollë;
- Organizimi i ekskursioneve;
- Planifikimi dhe realizimi i anketave lidhur me cilësitë e shkollës;
- Kujdestaria në shkollë.

Punë tjera do të realizohen sipas nevojave të vazhdueshme:

- Analiza e suksesit në fund të gjysmë vjetorit të parë;
- Vlerësimi i suksesit në fund të vitit;
- Vlerësimi final i suksesit pas përfundimit të provimeve ri-provuese.

Këshilli i klasave

Të gjithë arsimtarët e një klase përbëjnë këshillin e klasës. Ata së bashku brengosen për suksesin si dhe për të gjitha elementet edukative. Obligativisht takohet çdo dy javë dhe analizon suksesin e mësimin, mungesave, jep mirënjohje dhe shqipton dënime si dhe zgjedh të gjitha problemet e lindura për atë kohë.

Në raste të jashtëzakonshme këshilli mbledhet me ftesë të kujdestarit nëse ka ardhur deri te ndonjë ngjarje e madhe e cila ka ndikim negativ në procesin mësimor-shkencor. Me mbledhje udhëheq kujdestari, ndërsa duhet të marrë pjesë edhe drejtori. Kujdestari do të mbajë procesverbalet dhe do të kujdeset për realizimin e të gjitha vendimeve të marra në mbledhje.

Analiza pedagogjike dhe statistika

Për analizë të të dhënave statistikore si dhe për analizën e suksesit është i ngarkuar Drejtori i shkollës dhe Këshilli i mësimdhënësve.

Pasqyrat statistikore për nevoja të MASHT-it si dhe për Drejtorinë Komunale të Asimit i punon Drejtori i Shkollës.

Trajnime profesionale të punëtorëve

Kuadri mësimor aftësohet në baza individuale dhe të organizuar.

Aftësimi individual bëhet përmes përcjelljes së literaturës profesionale. Të gjithë mësimdhënësit kanë mundësi të parapaguhën në revista përkatëse dhe kanë qasje në internet përmes së cilit mund të përcjellin të arriturat shkencore në lëmit e tyre.

Aftësimi profesional i organizuar realizohet përmes:

- Punës nëpër aktive profesionale në rajon;
- Punës në këshillin e mësimdhënësve;
- Përcjelljes së këshillimeve profesionale;
- Pjesëmarrjes nëpër seminare;
- Seminareve në nivel të shkollës (4 seminare tematike gjatë vitit shkollor).

Për trajnimet jashtë shkollës drejtorja cakton një ose me shumë arsimtar dhe ai/a jo obligohet që pas kthimit nga seminari të raportojë dhe të informojë të gjithë kolegët e tij për përmbajtjen, të arriturat dhe se çka pritët në të ardhmen nga ato seminare.